

**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.09-318/1 dt. 11.03.2016**  
**PËR SHPALLJEN E VENDIMIT PËR NKP”STANDARD”-DIBËR**

**516.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

Shpallet vendimi për NKP”Standard”-Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 33<sup>të</sup> dt. 10.03.2016.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

**517.**Në mbështetje të dispozitave të Ligjit për financimin e njësive të vetqeverisjes lokale (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 61/2004, 96/2004, 67/2007, 156/2009, 47/2001 dhe 192/2015), nenit 36 të Ligjit për vetqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/2002) si dhe nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr. 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 33<sup>të</sup> dt. 10.03.2016 solli :

## **V E N D I M**

1. Këshilli i Komunës Dibër miraton Programin për servisimin e borxhit për mospagesën e kontributeve nga viti 2002 deri më 31.12.2014 të Ndërmarrjes Komunale Publike “Standard”-Dibër.
- 2.Jepet garancion për ngarkesë të NKP”Standard”-Dibër me kredi me kamata të volitshme te institucionet financiare, me qëllim të pagesës së borxhit të mbetur në emër të kontributeve të papaguara nga viti 2002 deri më 31.12.2014 të Ndërmarrjes Komunale Publike “Standard”-Dibër , sipas programit për servisim të borxhit.
- 3.Kopje e vendimit t’i dërgohet NKP”Standard-Dibër.
- 4.Ky vendim hyn në fuqi një ditë pas shpalljes në Kumtesën zyrtare të Komunës.

**Nr.08-315/3**  
**10.03.2016**  
**D i b ë r**

**KËSHILLI I KOMUNËS**  
**Kryetari,**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**

**P Ë R M B A J T J A**

516	Konkluzion për shpallje të Vendimit për NKP”Standard “ -Dibër	_____	1006
517	Vendim për NKP”Standard “ -Dibër	_____	950

**PËRGATITI : SHËRBIMI PRANË KËSHILLIT**